

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE “BLERJE DIPLOMASH PËR UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Printimet mbi karton:

- Printim i dixhitalizuar i të dhënave në Diplomë (në figurën orientuse tekstet mbi vizat bosh - **a**)
- 4 ngjyra LASER-cmyk (**kategorikisht jo printime ink**). Sfond 97-98 % 4-color-cmyk, hapësira e printimit mbi karton 20 x 28 cm (në figurën orientuese - **b**)
- Në emertesën DIPLOMË (2 x10cm), thellësi e goditjes 2.0 mm (në figurën orientuese - **c**) dhe fjalët DEKAN, REKTOR (2 x 0.2cm) thellësi e goditjes 1.0 mm (në figurën orientuese - **d**)
- I nxehte (varak) 3 - ngjyra logo e Republikës (në figurën orientuese - **e**)
- Nr.serie 1-color U - vizibel (ultravjolete) (në figurën orientuese - **f**)
- Shkrim i perdorur me gërma (font) **Trajan Pro** dhe **Adobe Pro**

Elemente sigurie:

- Printim U - vizibël (ultravjoletë) i numrit të matrikullimit dhe numrit të diplomës (për çdo diplomë, në total 5340); (në figurën orientuese)
- Logo U-vizibel (ultravjolete), formati max. 20x20 mm (në figurën orientuese - **j**)
- Ngjitje holograme 2-color rrethore 25mm (në figurën orientuese - **k**)

Të dhënat e hologramës:

- **1850** copë (diploma vertikale) forma rrethore me diametër ϕ 20 cm, me orientim në 2 dimensione në të cilat evidentohet sipas refleksionit, ngjyrë argjendi në germat UMT;
- **3490** copë (diploma horizontale) forma rrethore me diametër ϕ 20 cm me orientim në 2 dimensione në të cilat evidentohet sipas refleksionit, ngjyrë floriri në germat UMT;
- Pulla ka formë rrethore me diametër ϕ 25 mm, me ngjyrë të argjendë, (*silver metalik*) dhe flori (*oro*) sipas sasive në listën përkatëse.
- Mbi të gjithë sipërfaqen vendosen disa shtresa (layers). Shtresa e parë e konfiguruar me shkronjat, mbi të vendosen *logo* e institucionit dhe *filigrama*. Të gjitha elementet shfaqen me reflekse të ndryshueshme sipas planit të shikimit. Mbi logon e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë të shkruhet me gërma UMT;
- Pulla duhet të ketë elemente sigurie të dukshme dhe të maskuar (holografikë dhe joholografikë) që sigurojnë vlerësimin e origjinalitetit të saj;
- Pulla përgatitet me material vetë-ngjitës (adeziv), që prishet nëse tentohet të çngjitet;
- Pulla duhet të jetë e përdorshme për tu ngjitur në diploma me dorë ose me makineri.

Të dhënat e kartonit:

300 gr/m2, super-fine, formati 22.5x33.3 cm

Një format diplome horizontalisht, një format diplome vertikalisht dhe formati i sipërcituar i diplomave (figura orientuese) janë bashkëlidhur Dokumenteve Standarde të Tenderit.

